

MATERIALE DHE DOKUMENTE

HAJRI SHEHU

DO TË HARTOHET NJË FJALOR I MADH I GJUHËS SHQIPE

Do të jetë një Fjalor me rreth 100 000 fjalë. Në rrethet tona gjuhësore, ky Fjalor është kërkuar që në vitin 2007. Madje, qe hartuar edhe një projekt. Por projekti nuk mori rrugë, siç u komentua atëherë, për arsye financiare. Kemi rastin të vlerësojmë shumë nismën dhe ngulmimin e Akademisë së sotme të Shkencave dhe posaçërisht, të Kryetarit të saj, profesor Skënder Gjinushit për vendimin për të hartuar dhe botuar një Fjalor të madh kombëtar të gjuhës shqipe. Fjalori do të jetë dyfish kombëtar. Më së pari, sepse do të përshkruajë gjuhën e kombit, por edhe sepse në këtë punë e në këtë vepër janë bashkatare Tirana, Prishtina, Arbëreshia. Drejtues i ekipit është akademik profesor doktor Jani Thomai.

Një si historik: Në punë fjalorësh kemi një traditë të vyer më se 385-vjeçare. Për fjalorë dygjuhësh e terminologjikë mund të krahasohemi me vende të zhvilluara europiane: Fjalori i parë latinisht-anglisht është botuar më 1588. Fjalori i parë latinisht-shqip është botuar më 1635 / nga Frang Bardhi (vetëm 47 vjet ndërmjet). Janë botuar më se 150 fjalorë terminologjikë shqip-gjuhë e huaj e gjuhë e huaj-shqip. Fjalori i parë kombëtar i gjuhës shqipe – *Fjalor i gjuhës shqipe* i Kostandin Kristoforidhit është botuar më 1904. 50 vjet më pas, më 1954 është botuar nga Instituti i Shkencave Fjalori tjetër kombëtar – *Fjalor i gjuhës shqipe*. Vitet 1980-2000 kanë sjellë të tjerë Fjalorë kombëtarë: Më 1980 u botua *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*; më 1984, 2002, 2004, 2006, 2020 – edhe fjalorë të tjerë. Fjalori më i fundit, që sapo ka dalë nga shtypi, me rreth 35 000 fjalë, është për shkollat.

E kërkon zhvillimi shoqëror këtë Fjalor: Fjalori i gjuhës shqipe (2006), më i madhi deri tani, përfshin rreth 50 000 fjalë. Brenda asaj prerjeje, besojmë që ai i ka përmbushur synimet dhe detyrat e tij. Por që atëherë kanë kaluar 15 vjet. Është një kohë jo fort e shkurtër. Më shumë se kaq, është një kohë me një zhvillim të madh të leksikut të shqipes në të gjitha trojet e saj. Leksiku është tërësia e fjalëve që ka një gjuhë. Ai e ndjek hap pas hapi zhvillimin shoqëror. Atëherë, ky leksik e ky zhvillim i leksikut kërkon domosdo një Fjalor më të madh, që ta nxërë. Shto këtu edhe fjalë me burim popullor nga të folmet

krahinore të shqipes, fjalë të arbërishtes, fjalë të vjetra ose të vjetruara me vlerë letrare potenciale për gjuhën standarde. Shto këtu edhe rritjen kuptimore dhe fjalëformuese të klasave të caktuara të fjalëve e të grupeve të caktuara tematike të fjalëve. Thënë me një fjali, duhet një Fjalor më i madh, me një makrostrukturë dhe mikrostrukturë më të madhe.

Tiparet e Fjalorit: Çdo fjalor ka tiparet e veta. Për shembull, *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe* (1980) ka një fjalës (fjalësi është tërësia e fjalëve që shpjegohen) të paarritshëm deri atëherë nga ndonjë fjalor pararendës (rreth 41 000). Edhe Fjalori i gjuhës shqipe (2006) ka një fjalës të paarritshëm deri atëherë (rreth 50 000). Kurse te Fjalori i madh i gjuhës shqipe, që do të hartohet e do të botohet aty nga viti 2023, do të jetë (po përdorim një si metaforë) perandoria e fjalëve. Te ky fjalor nuk është ajo vështirësia si te Fjalorët e mëparshëm – kufizimi që vjen nga tipi, prerja e madhësia e fjalorit. Korpusi i tij është shumë i gjerë. Ai do të ketë, siç u tha, rreth 100 000 fjalë, pa përmendur njësitë frazeologjike, fjalët e urta etj.

Fjalori i madh hartohet tani, kur tashmë *gjuha shqipe ka standardin e vet kombëtar*. Standardi kombëtar është varianti i gjuhës që nuk kufizohet në një truall të caktuar dhe që me formën e tij të shkruar dhe edhe të folur (televizionet, radiot etj.) shërben si mjet komunikimi për tërë shoqërinë. Është i kodifikuar. Dhe, kësisoj, ka rol dhe funksion modelues. Prandaj është paracaktuar për t'u bërë mjet komunikimi edhe për ato grupe folësish që nuk e përdorin ende. Kësisoj, i shërben gjithë kombit e është për të gjithë bashkëkombasit. Dhe Fjalori kombëtar e ka për detyrë ta pasqyrojë këtë standard kombëtar sepse, si vepër themelore e gjuhës shqipe, ka rolin dhe funksionin të jetë ruajtës e simbol i tij. Fjalori e ka për detyrë ta përhapë dhe ta përforcojë standardin. “*Duke përhapur dhe përforcuar normën letrare, - thotë profesor Androkli Kostallari, - ai (Fjalori – H.Sh.) sanksionon rrugët ku do të ecë zhvillimi i leksikut të gjuhës sonë edhe në të ardhmen.*”^{*} Fjalori kombëtar e ka për detyrë t'u mësojë të tjerëve si ta përdorin standardin gjuhësor. Prandaj Fjalori do ta pasqyrojë zhvillimin e gjuhës standarde e të leksikut të saj, më së pari, duke përbushur detyrat e tij koduese. Falë modelizimeve të tij, Fjalori do të na nxisë për të gjetur edhe mundësi të reja, për ta çuar më tej, sidomos standardin leksikor.

Një ndër çështjet qendrore në punë të hartimit të një fjalori është *çfarë të përfshijë e çfarë të lërë jashtë*. Për këtë përzgjedhje, gjykimi më i parë vjen, sigurisht, te vlera objektive e aksh fjale në sistemin dhe në strukturën e gjuhës. Dhe kjo vlerë objektive është te fjala që përdoret realisht dhe pajtohet me prirjet e zhvillimit të leksikut dhe të gjuhës, në tërësi, domethënë, që u

^{*} A. Kostallari, *Parimet themelore për hartimin e “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe”*, në “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, Tiranë, 1972, f. 83.

korrespondon modeleve prodhimtare të gjuhës. Një shembull: Nga ana strukturore, në themel të çdo fjale të përbërë (tipi *vendbanim / ka edhe tipa të tjerë*) është, përgjithësisht një lloj i caktuar togfjalëshi (*vendi i banimit*). Ndërsjellash, çdo fjalë e përbërë mund të kthehet, në një mënyrë a në një tjetër, në togfjalësh. Por prirja e sotme nuk është pëlqimi i togfjalëshit, por i fjalës së përbërë. Ndoshta, edhe për ekonomi gjuhe. Kjo do të thotë atëherë që në fjalësin e Fjalorit mund të ketë relativisht jo pak fjalë të përbëra (emra, mbiemra etj.). Por, sigurisht, për këto pëlqime e për këto zgjidhje ka kritere. Janë kriteret shkencore (për hartimin e Fjalorit), hartuar nga profesor Jani Thomai (akademik) e miratuar nga grupi i punës.

Ka një teori gjuhësore - tërësisht shqiptare në punë të pasqyrimin në Fjalorët tanë kombëtarë të leksikut popullor krahinor me vlerë letrare potenciale. Nuk e teprojmë aspak, po të themi që atë mund ta huazojnë edhe gjuhë të tjera, me histori e zhvillim si gjuha shqipe. Ky Fjalor – edhe ngaqë ka hapësirë të madhe – do të pasqyrojë më shumë fjalë e frazeologji, klasa fjalësh e grupe tematike fjalësh nga të gjitha të folmet krahinore të shqipes, në të gjithë truallin shqiptar. Edhe nga të folmet arbëreshe. Janë fjalë e shprehje që rrojnë në popull, të cilat, për arsye historike, jashtëgjuhësore nuk kanë mbërritur te gjuha standarde. Ka prej tyre që nuk kanë mbërritur as te letërsia e deritanishme artistike, nga ku mund të vilesnin për Fjalorë. Ka nga ato që, për arsye të kufizimit, që ka ardhur nga tipi i aksh Fjalori, nuk kanë mbërritur as te *Fjalori i gjuhës shqipe*, 2006. Vetëm nga Aksioni i madh për mbledhjen e fjalës popullore në vitet '80 të shekullit të mëparshëm, në Kartotekën e leksikut të shqipes kanë ardhur rreth 190 000 fjalë, kuptime fjalësh e frazeologji. Shto edhe mijëra fjalë e frazeologji që janë botuar në fjalorë krahinorë ose në revista shkencore gjuhësore në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni të Veriut, Mal të Zi, Arbëreshi. Të gjitha këto presin të pasqyrohen në Fjalor, për t'ia rikthyer popullit si mjet kulture. Edhe, thjesht për informacion gjuhësor, ato janë me vlerë të jashtëzakonshme për shkrimtarët, etnografët, leksikografët, leksikologët, dialektologët, historianët e gjuhës etj. Ato janë me vlerë letrare potenciale, por mund të fitojnë vlerë letrare reale, kur sjellin pasuri për standardin. Si mund ta fitojnë vlerën letrare reale? Ka mënyra e mekanizma për këtë. Dhe Fjalori do të ketë rol të veçantë në tubimin e normativizimin e fjalëve që mund të vijnë nga të folmet krahinore – gjithnjë, pa ndërhyrje përveçuese, por vetëm sipas kriterit të vlerës letrare potenciale objektive. Për arsye të njësisë (unitetit) së shqipes, normativizimi i tyre është krejt i mundshëm. Ai ka të bëjë më shumë me variacionin fonetik-shqiptimor. Ky normativizim do, sigurisht, formimin gjuhësor-dialektologjik dhe intuitën e përgjithshme gjuhësore të hartuesve për ta njëjtësuar (identifikuar), më së pari, fjalën, në mënyrë që të ruhet, patjetër krejt qartë struktura morfologjike-fjalëformuese dhe përmbajtja kuptimore e njësisë.

Në punë të shtresave leksikore të fjalëve: Fjalori do të përfshijë, sigurisht edhe fjalë të zakonshme, me denduri të madhe përdorimi e funksionalisht të rëndësishme, por edhe fjalë të pazakonshme e me denduri jo të madhe përdorimi (tipi *kushtetues*), të domosdoshme për vlerat gjuhësore e sociale. Besojmë se do të shihen me vëmendje të veçantë fjalët e leksikut bisedor, por edhe fjalët që janë në periferi të gjuhës standarde. Sigurisht, Fjalori do të ketë teknikat e veta për të treguar statusin e tyre gjuhësor. Fjalori nuk mund të ketë ideologjizma e politicizma sepse nuk i kërkon koha; por besojmë do të ketë biblizma e kur'anizma që kanë të bëjnë me veprimtaritë fetare. Fjalori do të shembullojë normat e përdorimit të mirë të gjuhës dhe kujdesin gjuhësor të folësve të kulturuar. Prandaj mendojmë që seksizmat e skatologjizmat nuk mund të zënë vend në Fjalor.

Fjalori do të na tregojë ligjshmërinë e fjalëve të reja. Ato kanë të bëjnë, më së pari, me terminologjitë tekniko-shkencore. Dhe terminologjitë tekniko-shkencore kanë të bëjnë me intelektualizimin e mëtejshëm të gjuhës. Në terminologjitë tekniko-shkencore ka edhe ndryshime. Ato vijnë zakonisht me rritjen e rolit që luajnë shkenca e teknika e zhvillimi i shkencës e i teknikës. Dhe kështu, edhe me zëvendësimin e një palë termash me një palë tjetër, që rezultojnë më të suksesshëm për nga koncepti, ndërtimi gjuhësor etj. Përdorimi i termave ka të bëjë me rolin e tyre shoqëror. Mjaft prej tyre, për arsye të përdorimit të tyre të përditshëm, e kanë kaluar ose mund ta kalojnë pragon terminologjik e janë kthyer ose mund të kthehen në leksik të përgjithshëm (tipi *ballore* në urbanistikë, *automobilizëm* në sport etj.). Qytetërim e zhvillim tregojnë. Dhe, siç u tha, ky Fjalor, meqë ka hapësirë më shumë, do të përfshijë edhe terma më shumë. Edhe prurje të reja gjuhësore joterminologjike që vijnë nga zhvillimi i jetës sonë sociale, sidomos pas viteve '90.

Me lëndën e tij, *Fjalori shkon përtej Rilindjes Kombëtare Shqiptare*. Për këtë arsye, në këtë Fjalor do të zërë vend edhe njëfarë leksiku pasiv. Do të jenë fjalë të vjetra ose të vjetruara. Vlera e tyre informuese ka të bëjë me tekste e kontekste të mëhershme – historike, letrare, folklorike etj. Natyrisht, nuk do të jenë fjalë që janë në kundërshti (kontradiktë) me përdorimin e sotëm (ngaqë janë gabime të papërligjura). Në parantezë, as nga letërsia moderne nuk mund të pranohet fjalë që është në kundërshti me përdorimin e sotëm (ngaqë është gabim i papërligjur).

Fjalori do ta japë leksikon e shqipes të strukturuar e të modelizuar me: drejtshkrimin e fjalëve, trajtat e tyre gramatikore themelore, përmbajtjen e tyre kuptimore, sinonimet (fjalët me kuptim të afërt), bashkëlidhjet fjalëformuese etj. Ai do të japë fushën e veprimtarisë ku përdoret fjala. Në këtë mënyrë, ai do të bëhet simbol i shquar i gjuhës shqipe standarde. Kësisoj, ai do të bëhet promotori më i suksesshëm, jo vetëm për ta ruajtur standardin, por edhe për ta zhvilluar atë më tej.

Detyra e një fjalori është të japë edhe *modele të përdorimit të fjalëve*, domethënë, të lidhjes së fjalës me fjalën. Kjo lidhje kuptimore (e fjalëve) ka vlerë pasthënëse për interpretimin e aksh kuptimi. Në këtë Fjalor të madh të gjuhës shqipe do të na vijë i plotë sistemi i përdorimit të fjalëve. Madje, ne mendojmë se ai do të jetë një bazë shumë e sigurt për një fjalor drejtligjërivor (ortologjik) të gjuhës shqipe.

Fjalori nuk është për leksikofilët. *Audienca e tij do të jetë e madhe*. Besojmë që do të ketë një rreth të gjerë përdoruesish, në radhë të parë, sepse do të ligjshmojë atë që realisht e ka gjuha. Ky ligjshmim lidhet drejtpërdrejt me gjuhën e shkruar. Dhe gjuha e shkruar është faktor njësuës. Po aq, edhe me gjuhën e folur (të radiove, televizioneve etj.), e cila nuk mund të jetë më pak standarde e më pak njësuëse se gjuha e shkruar. Me fjalët popullore krahinore, me vlerë letrare potenciale, Fjalori do të jetë përbashkuesi i gjuhës shqipe. Për shkrimtarët e leksikologët – një det i pafund fjalësh, shprehjesh, kuptimesh e ngjyrimesh kuptimore.

Fjalori *do t'ia rritë më tej prestigjin ndërkombëtar gjuhës shqipe* me fjalorët shqip-gjuhë e huaj. Një ndër arsytet është kjo: Te fjalori dygjuhësh, fjalësi (tërësia e fjalëve, të renditura alfabetikisht te kolona e parë e fjalorit dygjuhësh), përmbajtja kuptimore e fjalëve, shembujt ilustrues për përdorimin e tyre etj. përsërisin zakonisht ato të fjalorit shpjegues njëgjuhësh. Dhe leksikografikisht, me këtë Fjalor shqipja mund të përballet denjësisht me çdo gjuhë të madhe të botës.

Fjalorët, si libra referimi, kanë të bëjnë shumë edhe *me përkthimin*. Dhe përkthyesi e do gjithnjë të ri fjalorin. Besojmë që ky Fjalor do t'ua plotësojë këtë dëshirë përkthyesve me fjalësin e madh e të përditësuar, me regjistrat e fjalëve, me shënimet që përshkruajnë konotacionet sociale etj. Ai do të jetë me siguri ndihmëtari i tyre i parë në punën përkthimore.

Fjalorët janë edhe gjuhësi. Argumenti më i parë konkret është ky: Të dhënat që vijnë nga fjalorët, e bëjnë gjuhësinë ta zgjerojë shumë bazën e vështrimeve të saja. Dhe nga ky Fjalor *do të vijnë më shumë të dhëna* për teoritë semantike, sepse ai është zbatim konkret i semantikës. (Semantika është degë e gjuhësisë që studion kuptimin e njëjësive të gjuhës.). Do të vijnë të dhëna që kanë të bëjnë me aspektin strukturor të gjuhës - gjeologjinë e fjalëformimit. Do të vijnë më shumë të dhëna që kanë të bëjnë me gjeografinë letrare të fjalëve. Të tjera të dhëna do të na sjellin histori dhe etimologji të fjalëve. Do të vijnë më të plota shumë informacione të tjera për fjalën e gjuhës shqipe, si, emërtimi shkencor për bimët etj. Nga të folmet arbëreshe do të vijë njësia (uniteti) e gjuhës.

Do të hartohen, sigurisht, ndërkohë ose më pas, fjalorë të tipave të tjerë – fjalorë të mëdhenj sinonimesh e antonimesh, fjalorë për gjuhën e shkrimtarëve, fjalorë shkollorë etj. Dhe ky Fjalor, do të jetë udhërrëfyes për ta.

Thonë që fjalorët janë librat më të mirë që mund të shkruhen për gjuhën. Urojmë që edhe ky Fjalor të jetë i tillë e të pëlqehet nga përdoruesit. Por pëlqimi vjen nga cilësia e tij. Grupi hartues është i përkushtuar për ta bërë sa më të mirë.